

SHPËRNGULJA E SHQIPTARËVE NË SIRI SI PASOJË E LUFTRAVE BALLKANIKE (1912-1913)

Gjatë viteve 1908-1912 shqiptarët morën pjesë aktive në ngjarjet e asaj kohe, qoftë në çetat e armatosura nëpër malet e Maqedonisë ose në protesta të tjera, siç ndodhi në tubimin e madh që u mbajt në Ferizaj, në korrik të vitit 1908. Të gjitha këto ndikuan në vendimin e sulltan Abulhamidit II (1876-1909) për shpalljen e kushtetutës më 23 korrik 1918¹. Me gjithë entuziazmin që u paraqit atëherë kudo në vilajetet osmane për kthimin në jetë të kushtetutës dhe zgjedhjeve parlamentare, gjendja në vilajetet me shumicë shqiptare, e sidomos në Kosovë, nuk u stabilizua pas kundërrevolucionit të prillit të vitit 1909, në të cilin shqiptarët ishin të pranishëm në të dyja anët². Si pasojë, çetat e armatosura filluan të aktivizohen sidomos në Vilajetin e Kosovës, gjatë viteve 1911-1912, kur shteti osman ishte në luftë kundër Italisë, pasi e zbarkoi ushtrinë në Vilajetin e Tripolit, sa që lëvizja u shndërrua në kryengritje të armatosur për autonomi. Pasi kryengritësit morën në dorë qendrën e vilajetit (Shkupit), qeveria osmane pranoi shumicën e kërkesave për një autonomi³. Mirëpo, ky pajtim midis shqiptarëve dhe qeverisë osmane nuk u pa me sy të mirë prej shteteve ballkanike, që kishin furnizuar shqiptarët me armë gjatë viteve 1910-1912. Ata shumë shpejt morën vesh për shpalljen

* Historian nga Kosova, anëtar i Akademisë Arabe në Damask (2000), i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës (2010) dhe Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Bosnje Hercegovinës (2018).

- 1 Sedriazemi në atë kohë ishte Ferit pashë Vlora (Avlonyali Ferit Pasa), i cili sqaron se sulltani «u kërkoi mendim të gjithë ministrave», por vetëm ai u shpreh qartë që «i duhej hapur rruga, e duhej vënë në jetë reforma», por me tubimin e shqiptarëve në Ferizaj gjatë korrikut të vitit 1908 ku u kërkua kthimi i kushtetutës, «fakti që ishte shqiptar mjaftonte për të hedhur dyshime mbi të si simpatizant i lëvizjes shqiptare». Kështu, më 21 korrik 1908, kur tubimi në Ferizaj po arrinte kulmin, sulltani vendosi që ta largojë Ferit Pashën: Abdulhamit Kirmizi, “Ferit Pashë Vlora, Një jetë shtet”, e përktheu Rubin Hoxham, Shkup (Logos A), 2018, f.432-434.
- 2 Më gjerësisht shih punimin tonë: “Mudhakkarat Isma’il Kamal ‘an al-tha’erah al- mudadah fi Istanbul- Ahdath 13-17 nisan 1909” (Kujtimet e Ismail Qemalit për konterrevolucionin në Stamboll- ngjarjet e 13-17 prillit 1909), Revista arabe për studimet osmane 7-8, Tunis 1993, f.11-28.
- 3 Noel Malcolm, “Kosovo – A Short History”, London (Macmilan), 1998, f.241-250.

e luftës kundër Perandorisë Osmane dhe ishin të interesuar për ndarjen e territoreve osmane në Ballkan midis tyre⁴.

Ndonëse Lufta Ballkanike u përcoll me parulla nacionaliste për «çlirimin e vëllezërve», ajo kishte edhe dozë antimyslimane, sidomos në viset që ranë nën pushtimin serbo-malazez, e manifestuar me vrasje dhe kryqëzimin e dhunshëm të shqiptarëve myslimanë në Kosovë, vrasje që u përshkruan në raportet diplomatike dhe në raportet e korrespondentëve ushtarakë në shtypin e majtë dhe të djathtë⁵. Si pasojë, shumë shqiptarë u detyruan të shpërngulen për në Stamboll e më tutje deri në Sham (Damask). Në Vilajetin e Shamit, sikurse në shumë vilajete të tjera, njerëzit dolën në demonstrata kundër veprimeve të dhunës, kundër myslimanëve civilë në zonat e pushtuara nga ushtritë ballkanike⁶, si dhe u botuan shkrime në shtyp që përshkruanin masakrat kundër shqiptarëve⁷. Ç'është e vërteta, Lufta Ballkanike e viteve 1912-1913 ishte si një tërmet me pasoja katastrofale për myslimanët e Ballkanit⁸.

4 Më shumë mbi marrëveshjet sekrete dhe përgatitjen e shteteve ballkanike për luftë shih: J.A.Marriott, "The Eastern Question: A Historical Study in European Diplomacy", Oxford, 1969, f.437-452; Nathalie Claire- Havier Bougarel, "Europe's Balkan Muslims- A New History", trans. Andrew Kirby, London (Hurst), 2017, f.51.

5 Midis shumë raporteve, me rëndësi janë ato të liderit bolshevik Leon Trocky, i cili në atë kohë ishte korrespondent ushtarak për disa gazeta ruse, sepse në to del kontrasti midis imazhit të Luftës Ballkanike jashtë (si luftë çlirimtare) dhe asaj në fushë beteja si luftë kundër civilëve myslimanë të pafajshëm: War Corespodence of Leon Trocky: "The Balkan wars 1912-1913", ed.G.Weissman and D, Williams, trans.Brain Pearce, New York (Pathfinder), 1981, f.158-161. Në lidhje me raportet diplomatike, u botua vonë një përmbledhje e mirë e raporteve të nënkonsullit britanik në Shkup W.D.Pecham, që ofron shumë informata për përdhunimet agresive të forcave serbe kundër shqiptarëve civilë në Maqedoni dhe në Kosovë: "Kosova-Një histori dokumentare nga luftërat ballkanike deri te Lufta e Dytë Botërore", red. Robert Elsie dhe Bejtulla Destani, Prishtinë (Koha), 2019, f.201-210 e tjera.

6 Gazeta siriane "al-Muktabas" ndër të tjera raportoi për një demonstratë në qytetin Dar'a në jug të Sirisë, ku demonstrantët kërkonin të shkonin në luftë për të mbrojtur myslimanët në Ballkan: al-Muktabas, Kajro, 27.10.1912.

7 Shtypi arab në Bejrut, Damask e Kajro përcolli me interesim të madh masakrat kundër shqiptarëve gjatë Luftës Ballkanike. Kështu, gazeta e njohur "al-Muktabas" citon në 01.12.1912, në gazetën "Daily Chronicle" se si forcat serbe vranë pesë mijë shqiptarë afër Prishtinës. Po kjo shifër, e të tjera përmenden në raportet e gazetës "Daily Telegraph": "Leo Freundlich, Albania's Glagotie", translated from german by S.S.Juka, NewYork 1991, reprinted in Prishtina 2001, f.45.

8 Kemi llogoraitje të ndryshme për numrin e viktimave dhe pasojat e spastrimit etnik në Ballkan gjatë Luftës Ballkanike në vitet 1912-1913. Monografia më e re tregon se nga numri i myslimanëve që ishin nën sundimin osman në Ballkan në vitin 1912(2, 315, 293) janë shpëtuar 812 771 myslimanë si refugjatë, prej të cilëve 10 904 në Vilajetin e Halepit dhe 3 187 në Vilajetin e Sirisë, kurse janë vrarë 632 408 të tillë: Justin A. MacCarthy, "Death and Exile: The Ethnic Cleansing of Ottoman Muslims 1821-1922", Priceton (Darwin Press),1995, f.161-164.

Në këtë kontekst, shumë familje shqiptare u tmerruan nga këto ndryshime të stuhishme, të shoqëruara me dhunë e masakra, dhe u detyruan të lënë vendlindjen dhe të shpërngulen nga Lindja, përkatësisht për në Stamboll e me tej deri në Damask, gjatë viteve 1912-1914. Kjo valë e parë do të hapte rrugën për valën e dytë, më e madhe se e para, shpërngulje që ndodhën gjatë dy luftrave botërore, si pasojë e politikës antishqiptare të SKS-Jugosllavisë⁹.

Kjo temë e ndjeshme për Kosovën u shtrua shkencërisht dhe publikisht vetëm pasi Kosova mori statusin e ri në federatën jugosllave në vitin 1974. Kështu, në vitin 1977, tematika e shpërnguljes së shqiptarëve u trajtua në një temë të magjistraturës me titull «Prania e shqiptarëve në Siri dhe roli i tyre në jetën siriane»¹⁰, e cila u botua si fejtון në gazetën kryesore të Kosovës në gjuhën shqipe (gazeta «Rilindja») gjatë atij viti, kurse në vitin 1978, shkrimtari Ali Olloni shkoi në Siri për një film dokumentar për «shqiptarët e Sirisë», me ç'rast u takua me disa pleq që u shpërngulën nga Kosova gjatë viteve 1912-1914, pra si pasojë e Luftës Ballkanike, dhe botoi disa artikuj me kujtimet e tyre¹¹.

Nga kujtimet e asaj gjenerate del se shpërnguljet filluan menjëherë pas shpërthimit të Luftës Ballkanike, përkatësisht pasi forcat serbe depërtuan në veri të Kosovës, pra duke filluar nga «vjeshta e vitit 1912». Në trenin që u nis nga Vuçitërna atëherë (tani Vustria) deri në Selanik, sipas kujtimeve të Abdulrahman Dobërlukës, ka pasur 400-500 «muhaxhirë». Ata nuk ishin mësuar me udhëtimin në det, ndaj vuajtën shumë për 7 netë, derisa arritën në Iskenderun të Sirisë. Me të arritur në Siri, filloi rekrutimi i të rinjve në ushtrinë osmane. Disa shkuan në Anadoll, e disa nuk u kthyen më. Kështu gjendja e atyre që mbetën të gjallë në Damask filloi të stabilizohej nga fundi i vitit 1918¹².

Nga kujtimet e Ahmet Prishtinës (1903-1990) del se «muhaxhirët» ndaleshin në rrugë nga Stambolli deri në Damask, disa ditë e deri në disa muaj. Në rastin e familjes së tij, ata u ndalën në Izmir, ku ai punoi për një kohë në një fabrikë pambuku, dhe pastaj vazhduan rrugën për në Damask, pasi morën vesh se atje kishte shqiptarë të Kosovës¹³.

9 Në atë kohë, mbreti Zog tregonte në një takim me ambasadorin turk në Tiranë, më 15.04.1934, admirimin e tij për Mustafa Qemalin : «Ju jeni shembull për në oksidentizmin e vendit»: Kopi Kyçyku, «Mustafa Qemal Ataturk», Tiranë,1994, f.80.

10 Muhamed Mufaku, «Prania e shqiptarëve në Siri dhe roli i tyre në jetën siriane», temë e magjistraturës, Fakulteti Filozofik, Universiteti i Prishtinës, 1977.

11 Ali Olloni, gazeta «Rilindja», Prishtinë 29.07.1978.

12 Ibid.

13 Më gjerësisht për hafëz Islamin dhe veprat e tij shih kaptinën «Hafëz Islam Prishtina në vitet e

Vala e parë e shqiptarëve që u shpërngulën si pasojë e Luftës Ballkanike dhe u vendosën më në fund në Damask, duke u bërë bërthamë e kolonisë shqiptare në Siri, dallohet nga disa karakteristika:

1. Pjesëtarët e kësaj vale nuk shkuan drejtpërsëdrejti në Damask, edhe pse kishin dëshirë për të arritur në këtë qytet të shenjtë (Sham sherif), por u vendosën përkohësisht në disa qytete në rrugë (sidomos në Kelis) para se të grumbulloheshin përsëri në Damask.

2. Pjesëtarët e kësaj vale erdhën nga vilajetet osmane (sidomos nga Kosova), pra ishin qytetarë osmanë, dhe u vendosen në dy vilajete (Halepi dhe Damasku) që mbetën nën sundimin osman deri në tetor të vitit 1918.

3. Pjesëtarët e valës së parë arritën në Damask në prag të Luftës së Parë Botërore, pra në një kohë të vështirë për shtetin osman. Ndaj, siç do të shohim në dorëshkrimin më poshtë, shqiptarët e ardhur në Damask u vendosen nëpër xhami, deri sa me kohë gjetën punë e dolën në shtëpi me qira.

4. Pjesëtarët e kësaj vale përfshinin familje fshatare dhe qytetare, përkatësisht familje me në krye ndonjë ulema ose familje të thjeshta që fëmijët e tyre u bënë të njohur më vonë në jetën siriane. Si shembull për të parën kemi hafëz Islam Prishtinën (vdiq në vitin 1929), i cili ishte myderriz në Prishtinë, hafëz, poet e autor i mevludit me emrin e tij (Mevludi i hafëz Islamit)¹⁴, kurse për të dytën kemi Husein Dobërlluka (1896-1974), fëmijët e të cilit u bënë figura të njohura në art dhe në letërsi, përkatësisht: Abdulatif Arnaut (1931), Abdulkader Arnaut (1936-1990) dhe Aishe Arnaut (1948)¹⁵.

5. Ndonëse në mesin e shqiptarëve të ardhur në Damask ka pasur ulema si hafëz Islami, sheh Hamdi Buhtiari etj., nuk kemi prej tyre ndonjë dorëshkrim që flet për reflektimet e tyre për vendlindjen, për Luftën Ballkanike, rrugën e shpërnguljes deri në Damask, si dhe për jetën e tyre në vendin e ri. Këtë mungesë e plotësojnë tri dorëshkrime të gjeneratës së dytë, përkatësisht të djemve që lindën në viset shqiptare ose në rrugë.

6. Prej atyre që lanë kujtime kemi dy që vlejné të përmenden. Autori i dorëshkrimit të parë është Abdulrahim Shabani (1912-2007), djali i Zejnulabedit që u largua nga Kosova në vitin 1914, kurse autori i dorëshkrimit të dytë është Abdulvehap Xheladini (1928-2004), djali i hafëz Islamit, që u largua nga Prishtina në vitin 1913.

fundit të jetës në Damask 1920-1929”: Figura shqiptare në Lindjen e Mesme- Shekujt XVI-XX, Shkup (Logos A), 2021, f.113-122.

14 Po aty.

15 Më gjerësisht për këto figura dhe rolin e tyre në jetën siriane shih: Muhamed Mufaku, “Lidhjet letrare shqiptare-arabe”, Tiranë (ACFOS), 2009, f.200-202.

7. Për këtë rast, zgjodhëm dorëshkrimin e parë, sepse ka më shumë të dhëna për rrethanat e largimit nga vendlindja dhe gjendjen e shqiptarëve që morën rrugën nëpër Anadoll, deri kur u vendosen më në fund në Damask, si dhe për qëndrimin e shtetit osman dhe banorëve ndaj tyre, derisa u rrit autori dhe u bë myezin-imam në një xhami të Damaskut.

Dorëshkrimi ka 7 faqe dhe mban titullin «Fragment biografie e Abdulrahim Shabanit, i lindur më 1912». Në dorëshkrim del se ai ishte vetëm dy vjeç kur familja e tij u shpërngul nga Kosova, pa përmendur prej cilit vend të Kosovës, ndaj kemi këtu kujtime me vlerë për vitet e para të ardhjes dhe vendosjes së shqiptarëve në vendin e ri, për vuajtjet e tyre pas mbarimit të sundimit osman dhe zbatimit të mandatit francez në ato vise. Këto janë të dhëna të dorës së parë që nuk i gjejmë në asnjë burim tjetër, përveç në gojëdhëna të trashëguara që nuk u ruajtën. Këtu kemi të dhëna të vlefshme për lagjet ku u vendosën shqiptarët atëherë, duke përfshirë edhe lagjen që e ndërtauan dhe u bë e njohur me emrin e tyre (Harat al-Arnaut), si dhe punët fizike që ushtronin për të fituar jetesën e përditshme etj.

Nga ana tjetër, dorëshkrimi përshkruan më pas shkollimin e autorit te hoxhallarë të ndryshëm të Kosovës e të Damaskut derisa u bë zëvendësimam në një xhami të njohur të Damaskut (al-Bidra'iya). Me fjalë tjera, autori përfaqëson një shtresë të mesme midis ulemave të formuar shqiptarë që erdhën në Damask (Islam Prishtina, Nuh Nexhati, Sulejman Gavoçi) dhe ulemave që u formuan në Damask dhe u bënë të njohur në botën islame (Nasiruddinal-Albani, Abdulkader Arnaut dhe Shuaib Arnaut). Megjithatë, sheh Abdulrahimi (siç u njoh në mesin e shqiptarëve të Damaskut) u dallua prej këtyre si i vetmi që la diçka me shkrim për shpërnguljen e shqiptarëve prej trungut të tyre gjatë Luftës Ballkanike. Ai përveç kësaj u njoh si njeri i mirë dhe i urtë, i cili është kujdesur të ruajë lidhjen me vendlindjen e tij deri në shtator të vitit 2000, kohë kur e mbaroi këtë dorëshkrim¹⁶.

Për botimin e këtij dorëshkrimi e pamë të udhës që brenda në tekst të ketë sa më pak ndërhyrje brenda kllapave [], kurse në fusnota të prezantohen figurat dhe monumentet e përmendura.

Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit

Fragment nga biografia e Abdulrahim Shabanit, i lindur në vitin 1912

“Kur doli i ati Zejnulabedin si muhaxhir prej vatanit të tij, i cili

16 Dorëshkrimi ruhet te djali i tij, Abdullah Shabani (1950), i cili e ruan në shtëpinë e familjes, në lagjen “Diwanija” afër Xhamisë së Arnautëve. E shfrytëzoj rastin për ta falënderuar z. Abdullah Shabani, i cili më dha një kopje të dorëshkrimit dhe lejen për botimin e tij.

është i njohur si vend islamik: (Kosova), në vitin 1914, ai erdhi me familjen në Sham [Damask] për t'u vendosur për gjithmonë atje. Ata banuan në ca dhoma të xhamisë "al-Fatih" në lagjen "Kaimariya"¹⁷

që ishin plot me muhaxhirë. Banorët e asaj lagjeje meritojnë të falënderohen për ndihmat e vlershme (ushqim, veshmbathje etj.) që ua ofruan atyre që lanë trojet, pronat e fiset e tyre, se

«Allahu nuk ua humb shpërblimin bamirësve»

[Kur'ani 11:115].

Disa muaj më vonë, erdhi urdhri prej shtetit osman që të gjithë muhaxhirët në Siri të dërgohen në vendet e Turqisë, si Adana, Kelis e të tjera, ku shteti do t'i jepte çdo familjeje shtëpi për banim e tokë për punë në bujqësi. E me të vërtetë, çdo njeri mori hakun ashtu siç u përmend. Pas një kohe, ndodhi lufta [e parë botërore] dhe ua solli njerëzve frikën, urinë, shumë lloj sëmundjesh, vdekjen e anarkinë, si vrasje e njerëzve për plaçkitjen e pasurisë e të tjera, sikurse tha Zoti në Librin e Shenjtë «Ne do t'ju sprovojmë me ndonjë frikë, meuri, me ndonjë humbje nga pasuria e jeta edhe nga frytet, po t'i jepni myzhdë durimtarëve, të cilët kur i godit ndonjë e pakëndshme thonë: Ne jemi të Allahut dhe ne vetëm tek Ai kthehemi. Të tillë janë që të Zoti i tyre kanë bekime e mëshirë dhe të tillë janë ata të udhëzuarit në rrugën e drejtë»

[Kur'ani 2: 155-157].

Ne u vendosëm atëherë në Kelis¹⁸. Babai më dërgoi në një shkollë shtetërore, mirëpo drejtori pasi më pa nuk më pranoi duke thënë në turqisht: "kuçuk", pra, "ky është i vogël".

-
- 17 Lagja "al-Kaymarija" është një prej lagjeve të vjetra të Damaskut (brenda murit rrethues). U bë e njohur me këtë emër, pasi princi aijubid Nasiruddin al-Qaimari e ndërtoi atë si vakëf para 650 AH/1252. Ajo funksionoi si e tillë deri në fund të sundimit osman (1918), e më vonë u shndërrua në xhami. Në këtë lagje ende kemi monumente bizantine, ajubide, mamluke dhe osmane.
- 18 Kelis tani është një qytet buzë kufirit turko-sirian. Gjatë sundimit osman u bë qendër sanxhaku në Vilajetin e Halepit, deri kur forcat angleze e pushtuan atë, në fund të vitit 1918 dhe ia dorëzuan Francës në fillim të vitit 1920, pasi e kishte marrë mandatin mbi Sirinë. Me Marrëveshjen e Ankarasë në vitin 1921, Kelisi hyri si qytet në kuadër të shtetit osman, kurse fushat e tij mbetën në kuadër të Sirisë, deri në vitin 1926, kur me vijën e re kufitare u futën në kuadër të Republikës së Turqisë.

Më vonë, babai më dërgoi te një hoxhë ulema, që ishte fqinji ynë me origjinë nga Kosova me emrin Mula Mehmet Pelshina, Zoti i bëftë rahmet. Ai më jepte mësim një orë në ditë, duke më shpjeguar në gjuhën tonë shqipe karakteristikat e shkronjave të Kur'anit, kur duhet të vokalizohen, të ndalen e të zgjaten. Kështu, me këtë metodë, për 8 muaj arrita në surë nal-Dharyat [Kur'ani 51]. Me ndihmën e Zotit e në saj të metodës së të ndjerit Mula Mehmet arrita të lexoja fjalët e Kur'anit që në moshën tetëvjeçare.

Mirëpo, për fat të keq nuk vazhdova më me të, sepse e lamë shtëpinë dhe shkuaam për banim në një xhami të braktisur në fund të qytezës, pasi shteti osman humbi luftën dhe erdhi Britania [me forcat e saj] në këtë vend, duke na nxjerrë nga shtëpitë që ua dhanë pronarëve të njohur me emrin "armenë". Pas kësaj, babai dhe muhaxhirët e tjerë vendosën të kthehen në Damask, sepse ai doli prej vatanit me qëllim të vendoset në Damaskun e shenjtë [Sham sherif] deri në vdekje.

Babai me muhaxhirët u nisën prej Kelisit për në Halep, me qerre me dy kuaq, e pastaj ata vazhduan rrugën me tren nga Halepi deri në Damask me shpenzimet e shtetit britanik. Ata u vendosën nëpër xhami sikurse herën e parë: disa u vendosën në Medresenë e Abdullah Pashës¹⁹ që ishte e braktisur atëherë, disa në al-Madrasa al-Bidra'iya²⁰ që kishte dhoma poshtë e lart, e disa në teqenë "Suleymanije"²¹ nga Lindja, ku u vinin ndihmat nga njerëzit e hajrit që Zoti nuk i harron.

-
- 19 U ndërtaua si vakëf nga Abdullah pasha Azmizade, në vitin 1779 në emër të të atit, Mehmet pasha Azmizade, valiu i Damaskut dhe Amir al-Hagj atëherë. Ky vakëf u pasurua edhe me një bibliotekë të vlefshme. Si e tillë, funksionoi deri në fund të sundimit osman (1918), kurse më vonë shërbeu si vend për vendosjen dhe ofrimin e ushqimit për muhaxhirët arnautë. Në gjysmën e dytë të shekullit XX, u shndërrua në pazar për artizanate orientale.
- 20 Al-Madrasa al-Badra'iya, një prej medreseve të njohura në Damaskun e vjetër (brenda murit rrethues). E ndërtoi si vakëf kadi al-kudat në Bagdad, Abdullahal-Badra'i dhe u hap me një ceremoni të madhe në vitin 1257 në praninë e guvernatorit ajubid të Damaskut al-Nasir Jusuf, dhe ndaj rruga ku gjendet quhet sipas emërimit të saj "Harat al-Badra'iya". Si e tillë, funksionoi deri në fund të sundimit osman, kurse më vonë u shndërrua në xhami me të njëjtin emër.
- 21 Është fjala këtu për Imaret al-Sulaymaniya, një prej vakëfeve të sulltan Sulejmani I (1520-1566), të cilin e ndërtoi mimar Sinani në vitin 1555, duke përfshirë xhaminë, medresenë dhe imaretin. Si e tillë funksionoi deri në fund të sundimit osman (1918), kurse gjatë viteve 1920-1950 shërbeu për vendosjen dhe ushqimin e muhaxhirëve arnautë dhe emigrantëve shqiptarë antikomunistë. Më vonë u shndërrua në muze ushtarak dhe u rinovua plotësisht në vitin 2009 me ndihmën e TIKAs.

[Ata u morën me punë të ndryshme] Disa punonin në copëtimin e gurëve nën diell për të shtruar rrugët, disa punonin si druvarë me pagë, disa si pastruese ose rojtarë në shkolla ose në administratën qeveritare. Kishte edhe punë të rënda si gërmime, të cilat i përballonin përkundër dobësisë fizike si pasojë e mungesës së ushqimit dhe gjajleve të jetës, sepse nuk donin që t'ua shtrinin dorën të tjerëve. Ata harxhonin më pak për ushqim dhe veshje, të nevojshme për të evituar të nxehtin e verës dhe të ftohtin e dimrit, vetëm për të kursyer diçka për të dalë prej xhamive e të vendoseshin nëpër shtëpi ku ishte më mirë e më me nder për ta. Pas një kohe të shkurtër, Zoti e lehtësoi me bujarinë e tij gjendjen e tyre, sa që shumica e tyre dolën prej xhamive dhe u vendosën nëpër shtëpi me qira në lagje të ndryshme si Hukur al-Saraja, Haratal-Dhababija, Hukural-Na'na²² e të tjera, ndërsa disa ndërtuam shtëpi në al-Diwaniya²³.

Sa i përket babait të ndjerë, ai kur erdhi me muhaxhirët në Damask, fjeti vetëm një natë në xhaminë "al-Bidra'ija", sepse ai duke falënderuar Zotin- kishte mundësi të paguante qira, ndaj gjeti një shtëpi me qira në lagjen "al-Zainabijah" përballë xhamisë "al-Sadat"²⁴, në fund të shtëpive të ndërtuara, pranë shtëpisë së të ndjerit Salahuddinal-Hatib, Zoti i bëftë rahmet, i cili ishte i njohur si kryenoter në Pallatin e Drejtësisë²⁵.

Pasi u vendosëm në shtëpinë e përmendur, babai më dërgoi në një shkollë private të hafëz Ahmadal-Dagistanit²⁶, në lagjen "al-

-
- 22 Hukur al-Saraja, al-Dhababija, Hukural-Na'na dhe Diwaniya ishin lagje të krijuara në kohën osmane, por u ndanë gjatë mandatit francez, me hapjen e bulevardit të ri (Rruga e Bagdadit) në vitin 1926.
- 23 Diwanija përfshinte fushat bujqësore në veri të lagjes "al-Imarah", kurse me hapjen e Rugës së Bagdadit në vitet '20 të shek. XX u nda dhe u bë lagje e re, pasi muhaxhirët arnautë e ngritën bërthamën e saj në vitin 1933, kurse me vonë ngritën Xhaminë e Arnautëve, e cila edhe sot mban këtë emër.
- 24 Xhamia "al-Sadat" ose "al-Sadat al-Zainabiyah" (ithtarët e Zainabit, vajza e Hazreti Alisë) u quajt kështu, pasi atje u rivarrosën shtatë prej ithtarëve të Hazreti Alisë (shiitë). Në të vërtetë, xhamia u ndërtua jashtë murit rrethues të Damaskut të vjetër, afër portës veriore "al-Salam", në vitin 1234. Në periudhën mamluke e rinovoi princi Ibn Mangjak, ndaj ndonjëherë quhej me emrin e tij. U rinovua edhe një herë më vonë në kohën osmane.
- 25 Ajo shtëpi ishte në periferinë veriore të Damaskut, kurse me hapjen e Rugës së Bagdadit ajo u bë bërthamë e lagjes së re "al-Hatib".
- 26 Po në vendin e përmendur, është Hai al-Dagistan (Lagjia e Dagistanëve) sipas emrit të muhaxhirëve nga Dagistani që u erdhën në Damask dhe u vendosen atje në mesin e shek.XIX. Nuk hasim në mesin e tyre një alim me këtë emër. Ndoshta autori e ngatërroi me alimin Ahmad

Asrunija” afër Dar al-Hadith²⁷, i cili ishte i njohur për dijen, modestinë dhe sjelljen e tij të mirë. Me ndihmën e Zotit e më punën e të ndjerit [al-Dagistani], gjatë dy viteve kam mësuar shkrimin, leximin, bukurshkrimin, duke mësuar të lexoj më mirë Kur’anin.

E lashë shkollën kur babai u largua nga lagjja “al-Hatib” dhe u vendos i në lagjen “al-Imarah”²⁸, në rrugën “al-Dhabijah”²⁹. Afër shtëpisë ishte një mjeshtrë i aftë, këpucëar, Lutfi al-Sabbag, që kishte punëtorinë në rrugën “Mit-hat Pasha”³⁰. Babai më dërgoi atje të mësoj zanatin, e pas një kohe më gjeti një nuse. Për katër vjet e kam mësuar mirë zanatin, kështu që babai më gjeti një dyqan afër dyqanit të vet, ku ai më mbante si bakall.

Pasi u ndava prej mjeshtrit dhe u bëra i lirë, me punën time jam orientuar përsëri për dije në mbrëmje te boxha ulema Nuh al-Savati³¹ në shtëpinë e tij në rrugën “Hukural-Saraja”. Ai ishte i njohur në lagjen “al-Uqaiba” për dijen, devotshmërinë dhe modestinë. Ai, Zoti i bëftë rahmet, nuk merrte para as për mësim e as për obligime fetare dhe as për xhenaze. Ai ishte i kënaqur me punën e tij si orëndreqës dhe paratë që fitonte prej kësaj pune.

Mirëpo, jam detyruar të shkëputem prej mësimave për shkak të punës, sepse punoja vetëm në dyqan pa ndonjë ndihmës. Megjithatë, ai i ndjeri vinte tek unë në dyqan ndonjëherë. Ai kishte dëshirë të dilte në natyrë ku nuk kishte rrëmujë, ndaj unë e shoqëroja ku kishte dëshirë të shkonte. Ndonjëherë shkonim të premtëve deri te

al-Dagistani (1892-1967).

- 27 Dar al-Hadith al-Ashrafija është një prej medreseve më të vjetra të Damaskut për hadith (tradita e profetit Muhamed), të cilin e themeloi në vitin 1233 guvernatori ajubid i Damaskut al-Ashraf, nipi i Salahuddin, në lagjen “al-Asruniya” pranë Kalasë së Damaskut, e cila është ruajtur deri sot.
- 28 Al-Imarah është një prej lagjeve të vjetra të Damaskut, ndahet në dy pjesë: pjesa më e vjetër (al-Gjuwwanija) brenda murit rrethues dhe pjesa më e re (al-Barranija) e kohës ajubide-osmane, e midis tyre është Babal-Faradis, një prej portave të vjetra të Damaskut.
- 29 Një prej rrugëve të lagjes “al-Imarah”, buzë varrezave “Dahdah”, që ishte banuar prej muhaxhirëve arnautë në vitet ‘20 të shek. XX.
- 30 Fjala është për rrugën e vjetër romane “Via Reckta”, e cila u emërtua në vitin 1878 me emrin e ri, pasi valiu i Sirisë, atëherë Mit’hat Pasha e rinovoi atë.
- 31 Fjala është për sheh Nuh Nexhatin (vdiq në vitin 1953), i ati i Nasiruddin al-Albani (1914-1999), i cili ishte një prej ulemave të njohur të Shkodrës në vitet e fundit të sundimit osman. Mirëpo, ai nuk u pajtua me reformat e para të Ahmet Zogut, ndaj u shpërngul me familjen në Damask, në vitin 1922. Në Damask jepte mësim në shtëpi, kurse ditën punonte si sahatçi (orëndreqës). Prej nxënësve të tij, arnautë ishin vetë djali Nasiruddinal-Albani, Abdulkadir Arnaut (1928-2007) dhe Shuaib Arnaut (1928-2016).

Duma me tramvaj³².

Në vitin 1943 jam emëruar me një vendim të Drejtorisë së Vakëfeve të Damaskut si myezin në xhaminë “al-Badraviya”, që gjendet në lagjen “al-Imarah”. Imami i kësaj xhamie ishte hoxha ulema i ndershëm Huseinal-Shatti³³, atëherë drejtor i Medresesë Islamike në rrugën “al-Naqib” të lagjes “al-Imara al-Gjuwanijja”. Unë e zëvendësova shpeshherë gjatë vijimit të mësimëve të texhvidit [të Kur’anit] te i ndjeri kryekurra Faizal-Dairatani³⁴.

Pas një kohe një kuura i ndjeri i njohur Abdulhamid Karim³⁵ pronari i medresesë [al-Nahdahal-Imiyah] në lagjen “al-Ukaibah”³⁶ më këshilloi duke më thënë: “Tani mirë je me dispozitat e texhvidit, por ende ke akcent në të lexuarin [e Kur’anit], ndaj do të ishte mirë të mësosh te hafizkurra hoxha Faizal-Dairatani, sepse është emëruar nga Drejtoria e Vakëfeve për të aftësuar imamët në medresenë “al-Kamilija” në lagjen “al-Buzuriya”³⁷ nga ora 7:30 deri në orën 9”. E falënderova atë dhe pa hezitim kam vijuar mësimin në atë medrese dhe, me ndihmën e Zotit, arrita të mësoj edhe një herë telavetin e Kur’anit te hoxha kurra Faizal-Dairatani, i cili ishte i njohur me dijen e tij të madhe në telavetët e Kur’anit, i cili i mësoi ato nga sheh i kurra ve i ndjeri [Salim] al-Halwani³⁸, imami i xhamisë “al-Tawba” në lagjen “al-Ukaiba”.

32 Në atë kohë Duma ishte një fshat në periferinë lindore të Damaskut që tërhoqte banorët e kryeqytetit për rekreacion në fundjavë, të cilët shkonin atje me tramvaj. Fshati u lancua në Damask në vitin 1907 dhe vazhdoi deri në vitin 1962.

33 Prej ulemave të Damaskut (1880-1962), ishte kadi në disa vende dhe drejtor i parë i Fakultetit të Sheriatit që u themelua në vitin 1942. U zgjodh sekretar i parë i Shoqatës së Ulemave të Sirisë që u themelua në vitin 1937.

34 Prej ulemave të njohur të Damaskut në kira’atët (1894-1965), ishte një kohë të gjatë imami i xhamisë “al-Taëba” në lagjen e përmendur “al-Imarah”.

35 Abdulhamid Karim (vdiq në vitin 1976) ishte prej ulemave të njohur të asaj lagjeje, ishte myderriz në medresenë “al-Kamilijah” dhe imam në xhaminë “al-Shamiyah”. Ai themeloi po në atë lagje medresenë “al-Nahdahal-Imiyah”.

36 Është një lagje e ndërtuar mbi një kodër, në veri të murit verior të Damaskut të vjetër. Ka shumë monumente ajubide e mamluke si xhamia “al-Tawbah”. Kjo lagje u zhvillua shumë gjatë sundimit osman me sarajet, hanet, xhamitë e tjera, sa që u quajt «Stambolli i vogël».

37 Prej tregjeve të vjetra në Damaskun brenda murit rrethues. Ishte në fillim për drithë, por në kohën osmane u shndërrua në treg për fara e erëza të ndryshme. Ka monumente ajbide, mamluke e osmane (hamama, hana, pallate etj.) si pallati i valiut të Damaskut, Esad pasha Azmizade (1742-1757), i cili u shndërrua në Muzeun Etnografik.

38 Salim al-Halwani (1868-1944) ishte djali i kryekurraut në Damask, Ahmad al-Halwani, ndaj përparoi në këtë fushë dhe e mori këtë titull pas vdekjes së të atit në vitin 1889. Ishte myderriz në medresenë “al-Kamilijah” dhe në xhaminë “al-Tawbah”, në lagjen “al-Ukaibah”.

O Zot, Ju lus me mëshirën tuaj të na hapni ne dhe myslimanëve që kanë shkuar, dyert e xhenetit, në ditën [e kiametit] kur të rinjtë plaken, dhe paqja qoftë mbi Profetin Muhammed dhe familjen e tij!

Autori është talebi Abdulrahim, djali i të ndjerit Zainalabedin Shaban, me xhumadaal-ahuhra 1421 hixhri, më 18 shtator 2000³⁹.

39 Prej ulemave të Damaskut (1880-1962), ishte kadi në disa vende dhe drejtor i parë i Fakultetit të Sheriatit që u themelua në vitin 1942. U zgjodh sekretar i parë i Shoqatës së Ulemave të Sirisë që u themelua në vitin 1937.

بِسْمِ اللّٰهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِیْمِ
 قطعة تاریخ حياة عبد الرحيم شعبان . تولد ١٩١٤
 حين هاجر المرحوم والده زين العابدين شعبان الى
 وطنه المعروف منطقة اسلاميه : قوصو ونعامية
 وانه جاء مع أسرته بالشام بقصد اقامته طول حياته
 والسكن كانت في غرف مسجد القيج في القرية .
 ملوء قبرا من المهاجرين وما يشكر من احياء تلك المنظمة
 بمساعدة منهم القيمة لولاد والذين تركوا ديارهم وحملتهم
 وعشيرتهم (من طعام ولباس وغيرهما) .
 وان الله لا يضيع اجر المحسنين .
 وان بعد بضعة اشهر : جاء امر من قبل دولة عثمانية
 ان كلا من الموجودين في سوريا من المهاجرين ياخذونهم
 منها وسوقهم الى مناطق تركيا : كمنطقة أضنه
 وبلدة : كلس : وغيرهما : وان لكل صاحب عائلة
 دار للسكن وارض للزراعة على حساب الدولة
 وفعلا قد نال كل صاحب حق حقه مثلما خصص له كما ذكر
 وبعد فترة من الزمن فقد فجئت ابواب الحرب للبشر من الخوف
 والجوع والامراض بأشكالها . والموت والفوضى كقتل النساء
 طمعا بماله او بغيره .
 (وَلَنَلْمُؤْمِنِينَ مِن بَيْنِ يَدَيْهِمْ جُوعٌ وَتَضَارِعٌ فِي الدُّنْيَا لِمَا كَفَرُوا
 بِاللَّائِنِ وَالَّذِينَ ظَلَمُوا وَإِنَّ رَبَّهُم بِمَا كَانُوا يَكْفُرُونَ)
 قَالُوا إِنَّا لِلّٰهِ وَإِنَّا إِلَيْهِ رَاجِعُونَ . الى آخر الآية .

(١) الناصح المذبح للاستاذ عبد الحميد كرم العيون صاحب الميراث القسبية رحمه الله تعالى

(١)
 وبعد فترة من الزمن نصحت احد القراء رحمه الله تعالى
 بالذهاب الى قرأتك باحكام التوحيد جيدة الا ان لمهية قرأتك
 الدرية العجمي واذا قرأت عند الشيخ المافظ المقرئ فاضل الديرعطاني
 فانه معين من مدينية الدواعي فافصا للامنة :
 في مدرسة الكالمية ذمى البيزورية : الدوام صباحا من الساعة
 والليلية من الساعة التاسعة :
 وكان الربوبية مني هناك الله خيرا :
 اني بشوق وبرغبة دون تردد وقد وفقني الله تعالى بكرمه
 ان اعد تلاوة القرآن الكريم مرة اخرى
 فعند المقرئ الشيخ الناصح المرحوم فاضل الديرعطاني رحمه الله تعالى
 وهو معروف بعلمه الواسع وحسن سلوكه المتنازل
 بوجوه القرات القرآنية الكريمة وتلاوتها الحقيقية
 مما اقتبس رحمه الله تعالى : بقلبه من نور القرآن الكريم
 من استاذة شيخ القراء المرحوم الملواني رحمه الله تعالى
 الشهير : في العنقية وامامها في جامع التوبة -

اللهم برحمتك افتح لنا وللمؤمنين والمؤمنات الذين
 استعونا بالايمان ابواب الجنة والغفران يوم تشيخنا في الازل

عن النبي صلى الله عليه وسلم على رسوله سيدنا محمد صلى الله عليه وسلم وآله وذريته

الموافق عام ١٤٠١ هـ / ١٤ جمادى الآخرة / عام ٢٠٢٠ م / ١٢ ربيع
 الثاني

Epitafi i varrit të sheh Abdulrrahimit në
varrezat “al-Dahdah” në Damask

هذا ما وعد الركنون
وصدق المرسلون
فخرج المرحوم الحاج
عبد الرحيم شهبان بن زين العابدين
توفي في ٢٩ ذي الحجة ١٤٢٧
الموافق ١٨ كانون الثاني ٢٠٠٧
صاحب هذا القبر
عبد الرحيم شهبان ابن
المرحوم زين العابدين شهبان